



IOM Internationale Organisatie voor Migratie

Postbus 10796
2501 HT Den Haag

T 0900 – 746 44 66 (€0,05 p.m.)

I www.iom-nederland.nl

KTHIMI

Programi REAN

Ndihmë me rastin e largimit nga Holanda

Keni ardhur në Holandë me qëllim që këtu të jetoni një kohë të gjatë. Ndoshta keni dyshime rreth ardhmërisë tuaj në Holandë. Dhe tash gjendeni para vendimit: të rri në Holandë, të ktheheni në vendit e prejardhjes tuaj ose të rivendoseni në një tjetër shtet. Po qe se mendoni të largoheni nga Holanda, në shumë raste për atë mund t'ju japë mbështetje Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM).

IOM-i është një organizatë e pavarur ndërkombëtare dhe nuk është pjesë e pushtetit holandez. Me kolegë në më shumë se 120 shtete IOM-i në mbarë botën angazhohet për interesat e migrantëve. IOM-i ju ndihmon vetëm po qe se ju dëshironi ndihmë.

Në këtë fletë informuese mund të lexoni se çka mund të bëjë IOM-i konkretisht me rastin e largimit tuaj nga Holanda.

Ndihmë nga IOM-i me rastin e largimit nga Holanda
Programi REAN

Ndihma plotësuese (financiare)
dhe shoqërimi

Cilat janë kushtet për largim me ndihmë të IOM-it?

Keni ardhur në Holandë me qëllim që këtu të jetoni një kohë të gjatë por në ndërkohë keni vendosur që përfundimisht të largoheni nga Holanda. Për ta mundur ndihmën gjatë largimit IOM-i ofron programin REAN, *Return and Emigration of Aliens from the Netherlands*.

Nga programi REAN mund të përfitonit po qe se i plotësoni këto kushte.

- Nuk mund ta paguani vetë udhëtimin.
- Mundeni (eventualisht me ndërmjetësim) të nxirrni një dokument të vlefshëm udhëtimi, apo tashmë posedoni dokument të vlefshëm udhëtimi (pasaportë ose lejekalimi).
- Pajtoheni që Shërbimi për Imigracion dhe Shtetësi (IND) ta përfundojë procedurën e hapur për leje të qëndrimit, apo ta tërheqë lejen tuaj të qëndrimit.
- Gjatë pesë viteve para bërjes së kësaj kërkesë nuk jeni kthyer me shërbime të rregullores REAN. Gjithashtu, gjatë pesë viteve të fundit nuk ju kanë dëbuar në llogari të pushtetit holandez.
- Nuk jeni shtetas i njërit nga shtetet e përjashtuara nga rregullorja REAN (Unioni Evropian dhe disa shtete të tjera perëndimore). Viktimat e trafikut me njerëz me prejardhje nga këta shtete munden megjithatë të përfitojnë nga rregullorja REAN.

Çka duhet pasur parasysh në rast rivendosjeje?

Se a do të vini parasysh për rivendosje varet nga kushtet për pranim të shtetit ku doni të shkoni për të jetuar. IOM-i organizon udhëtimin vetëm në rast se keni marrë leje për t'u vendosur në një shtet të tretë. Është e rëndësishme që leja për rivendosje të rregullohet me kohë. Kjo për arsye se procedura e rivendosjes, varësisht nga rrethanat tuaja personale dhe nga procedurat që i vijon shteti i destinacionit, mund të zgjatë shumë.

Çka mund të bëjë IOM-i për ju në rast kthimi?

- T'ju këshillojë e t'ju informojë rreth kthimit ose vendosjes në shtet tjetër.
- T'ju këshillojë rreth nxjerrjes së një dokumenti për udhëtim si edhe t'ju japë një kompensim për shpenzimet e bëra për rregullimin e një dokumenti që zëvendëson dokumentin e udhëtimit.
- Të rregullojë një biletë avioni për një drejtim deri tek aeroporti që ndodhet sa më afër destinacionit tuaj.
- T'ju ofrojë shoqërim në aeroportin Schiphol, dhe sipas nevojës, edhe në aeroportin e destinacionit.

Çka mund t'ju jepet, varësisht nga situata juaj, si ndihmë plotësuese?

- Ndihmë financiare për shpenzimet që i bëni për jetesë gjatë ditëve të para pas largimit tuaj nga Holanda. Lartësia dhe akordimi i kësaj shume varet nga përbërja e familjes si edhe nga situata e qëndrimit tuaj në Holandë.
- Eventualisht një kontribut financiar për shpenzimet e transportit nga aeroporti deri te destinacioni përfundimtar në vendin tuaj.

Përveç ndihmës nga programi REAN IOM-i ofron edhe ndihmë plotësuese (financiare) dhe shoqërim në formë të:

Këshilla dhe informim

IOM ka orare fikse për pranim të palëve në vende të ndryshme të Holandës. Edhe në vende të tjera mund të caktoni me telefon një termin për të kërkuar këshilla dhe informacione nga IOM-i, si për shembull në:

- Qendra për azilkërkues
- Zyra të shoqatës Vluchtelingenwerk
- Qendër për strehim nevoje
- Burg për të huajt
- Organizata për migrantë
- Ente shoqërore
- Ente kishtarë
- Seli komunash

Përveç kësaj IOM-i vë në dispozicion informata edhe në vende joformale ku mund të gjenden migrantë.

Shoqërim individual

IOM-i ofron ndërmjetësim plotësues për:

- Njerëz me probleme shëndetësore.
- Të huajve me moshë të mitur që janë vetë (AMV).
- Viktimave të trafikut me njerëz.
- Migrantëve në pozitë të lëndueshme.

Ndihmë riintegrimi

Bashkë me kolegë në mbarë botën IOM-i mundohet që sa më mirë të ndihmojë gjatë tërë procesit të kthimit dhe trajektit të riintegrit.

Njoftime të gjerësishme lidhur me ndihmën (financiare) dhe shoqërimin plotësues mund të gjenden në www.iom-nederland.nl si edhe në fletët informuese përkatëse.

Doni kontakt me IOM-in?

Telefononi:

0900 – 746 44 66 (€0,05 p.m.)

Nga teksti i kësaj flete informuese nuk mund të rrjedhë asnjë e drejtë.